



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 shtator 2019  
Nr. ref.:RK 1430/19

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI200/18**

Parashtrues

**Sokol Haziraj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të  
Republikës së Kosovës, Rev. nr. 261/2018, të 30 tetorit 2018**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Sokol Haziraj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Naser Peci, avokat.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit Rev. nr. 261/2018 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të 30 tetorit 2018, të cilin e ka pranuar më 15 dhjetor 2018.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Efektive Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin mëtejme Konventa), si dhe me Protokollin nr. 7 të saj.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 21 dhjetor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
7. Më 17 janar 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe plotësimin e saj me dokumentacion relevant. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 4 shtator 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Më 1 nëntor 1996, Gjykata Komunale në Prishtinë me aktin Vr. nr. 6399/96, e vërtetoi kontratën e lidhur ndërmjet N. G. (shitësi) i cili përfaqësonte J. G. dhe N. V. (blerësja), mbi shitblerjen e paluajtshmërive nr. 653/1 dhe nr. 653/2, në vendin e quajtur "Novo Lojze" në sipërfaqe të përgjithshme prej 027.02 ha, me kulturë arë e klasit të IV, zona kadastrale Çagllavicë, komuna e Prishtinës.
10. Më 21 nëntor 2000, Gjykata Komunale në Prishtinë me aktin Vr.nr. 3487/2000, e vërtetoi kontratën e re të lidhur ndërmjet N.V. (tani shitësja) dhe N. G., (tani blerësi).

11. Më 26 shtator 2009, paditësi J. G. paraqiti padi kundër të paditurit N.G. për lidhje të kontratës në mënyrë të paaautorizuar me N.V., duke kërkuar nga gjykata që kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në fjalë të anulohet për shkak se të njëjtës i mungonin elementet qenësore, respektivisht vullneti i palëve, pagesa e çmimit dhe dorëzimi i paluajtshmërisë, e që sipas dispozitave ligjore të LMD-së, mungesa e këtyre elementeve e bënë kontratën të pavlefshme. Në cilësinë e ndërhyrësit në procedurë, propozim për aprovimin e padisë së J.G. nga gjykata e shkallës së parë kishte bërë edhe parashtruesi i kërkesës.
12. Më 22 dhjetor 2009, Gjkata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C.nr. 397/2006, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit J. G. dhe propozimin e parashtruesit të kërkesës si ndërhyrës, duke vlerësuar se nuk kishte prova të mjaftueshme për aprovimin e kërkesëpadisë, nëpërmjet të cilës është kërkuar anulimi i kontratës së lidhur ndërmjet N. G. dhe N. V.
13. Parashtruesi i kërkesës dhe paditësi J. G., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 22 dhjetorit 2009, parashtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.
14. Më 14 maj 2010, Gjkata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 240/2010, e refuzoi si të pabazuar ankesën e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës, si ndërhyrës dhe paditësi J. G., duke konfirmuar kështu Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 22 dhjetorit 2009.
15. Parashtruesi i kërkesës dhe paditësi J. G., kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 14 majit 2010, parashtruan kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të dy Aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të pranohet si e bazuar ose Aktgjykimet të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Kundër të njëjtit Aktgjykim, edhe Prokurori i Shtetit kishte ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Aktgjykimet e kontestuarra të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.
16. Më 16 prill 2013, Gjkata Supreme me Aktgjykimin Rev.Mlc.nr.217/2010, hodhi poshtë si të palejuar kërkesën për revizion të ushtruar nga parashtruesi i kërkesës, refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të ushtruar nga paditësi J.G., ndërsa kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të ushtruar nga Prokurori i Shtetit e konsideroi të tërhequr, me kërkesë të prokurorit. Pas marrjes së vendimit, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar sqarim nga Gjkata Supreme rreth ankesës së tij, e cila më 14 maj 2013, nëpërmjet kryetares së Kolegjit shqyrtues e udhëzon parashtruesin e kërkesës që në lidhje me këtë çështje t'u drejtohet gjykatave të instancës më të ulët.
17. Më 14 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjkata Themelore në Prishtinë, që ankesa e tij t'i dërgohet Gjykatës së Apelit, për të vendosur në

merita. Nëpërmjet kësaj ankese parashtruesi i kërkesës kontestoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 22 dhjetorit 2009, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që: *“... ankesën e ndërhyrësit ta aprovojë si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë ashtu që ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit ose aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje”*.

18. Më 28 mars 2017, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin Ac. nr. 1887/13, e hodhi poshtë si të palejuar ankesën e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, duke arsyetuar mes tjerash se: *“Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të LPK-së, ka gjetur se: Ankesa e të autorizuarit të ndërhyrësit është e palejuar.” (...)* Në kuptim të dispozitave të cituara gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar dhe ka vendosur që ankesën e të autorizuarit të ndërhyrësit ta hedhë poshtë si të palejuar sepse aktgjykimi i ankimuar është vërtetuar në tërësi me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 240/2010, i datës 14. 05. 2010, dhe nga kjo datë i njëjti në tërësi ishte bërë i plotfuqishëm”.
19. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1887/2013, të 28 marsit 2018, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.
20. Më 30 tetor 2018, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr. 261/2018, refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të ushtruar nga parashtruesi i kërkesës, duke arsyetuar se vendimi i shkallës së dytë ishte bërë i formës së prerë, sepse: *“Gjykata Supreme ... me aktgjykimin e saj Rev. Mlc. nr. 217/2010 të datës 16.4.2013, e ka refuzuar si të pabazuar revizionin e paditësit i paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 240/2010 të datës 14.5.2010 dhe e ka hedhur si të palejuar revizionin e të autorizuarit të ndërhyrësit i paraqitur kundër aktgjykimit të lartcekur, kurse kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruar nga Prokurori i Shtetit të Kosovës kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac.nr.240/2010 të datës 14.5.2010 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr. 397/2006 të datës 22.12.2009, e ka konsideruar të tërhequr. Nga kjo rrjedh se edhe në procedurën sipas mjeteve të jashtëzakonshme është konfirmuar vendimi i gjykatës së shkallës së dytë përkatësisht i shkallës së parë”*.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i është shkelur e drejta e tij themelore për të përdorë mjete efektive juridike të garantuara me nenin 32 të Kushtetutës, *“Pjesë përbërëse e të drejtës së mbrojtëse juridike është pikërisht e drejta për mjete efektive juridike të cilën e njeh edhe Konventa Evropiane, neni (13). Protokolli nr. 7 në Konventën Evropiane garanton të drejtën e ankesës ashtu që çdo kush ka të drejtë që rastin e tij ta shqyrtojë gjykata më e lartë”*.

22. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“rasti i ndërhyrësit nuk është shqyrtuar nga gjykata e shkallës së dytë sipas meritave të ankesës por me lëshime të gjykatës është hedhë poshtë si e palejuar”.*
23. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që kërkesa të shqyrtohet në merita; të konstatojë shkelje të së drejtës për mjete juridike, si dhe të anulojë Aktvendimin Rev. nr. 261/2018.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

24. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

[...].”

26. Gjykata po ashtu i referohet neneve: 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

[...]

*“2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”*

27. Sa i përket plotësimit të këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML nr. 208/2017, pasi kishte shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu paraqiti kërkesë në pajtim me afatin e paraparë në nenin 49 të Ligjit.
28. Megjithatë, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, që përcakton:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
29. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, e ndërlidhur me nenin 13 të Konventës, dhe me Protokollin nr. 7 të saj, për shkak se ai konsideron se ankesa e tij si palë ndërhyrëse në procedurën e iniciuar nga paditësi J. G. nuk është shqyrtuar në merita nga gjykatat e rregullta.
30. Në rastin konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e neneve të sipërcekura, u janë përgjigjur gjykatat e rregullta dhe nëse konkluzionet e tyre janë të arsyetuara dhe bindëse.
31. Gjykata vëren se pretendimit të parashtruesit të kërkesës të ngritur në ankesë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 22 dhjetorit 2009, Gjykata e Apelit e kishte arsyetuar si në vijim: *“Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të LPK-së, ka gjetur se: Ankesa e të autorizuarit të ndërhyrësit është e palejuar”. (...) Në kuptim të dispozitave të cituara gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar dhe ka vendosur që ankesën e të autorizuarit të ndërhyrësit ta hedhë poshtë si të palejuar sepse aktgjykimi i ankimuar është vërtetuar në tërësi me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 240/2010, i datës 14.05.2010, dhe nga kjo datë i njëjti në tërësi ishte bërë i plotfuqishëm”.*
32. Për më tepër, Gjykata e Apelit më tej arsyetoi: *“Gjykata e Apelit përfundimin për ta hedhur poshtë ankesën e mbështet edhe në faktin se kërkesa e ndërhyrësit me aktgjykimin e gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 397/06, i datës 22.12.2009, ishte e vendosur me pikë të veçantë në dispozitivin e aktgjykimit-pika IV (katër) e dispozitivit dhe kur Gjykata e Qarkut në Prishtinë, ka vendosur sipas ankesës së paditësit me Aktgjykimin Ac. nr. 240/2010 të datës 14.05.2010, pikën IV (katër) të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë nuk e ka lënë pa e shqyrtuar por ka vendosur që aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet në tërësi. Në momentin që aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar në tërësi nga gjykata e shkallës së dytë, atëherë aktgjykimi i shkallës së parë mund të ndryshohet vetëm me mjete të jashtëzakonshme, sepse mjetet e rregullta të goditjes ndaj aktgjykimit të formës së prerë nuk lejohen si në këtë rast”.*

33. Gjykata, gjithashtu vëren se pretendimit të parashtruesit të kërkesës i është përgjigjur në mënyrë gjithëpërfshirëse edhe Gjykata Supreme, e cila në Aktvendimin lidhur me revizionin, ndër të tjera, arsyetoi: *“Gjykata Supreme ... me aktgjykimin e saj Rev. Mlc. nr. 217/2010 të datës 16.4.2013, ... e ka hedhur si të palejuar revizionin e të autorizuarit të ndërhyrësit i paraqitur kundër aktgjykimit të lartcekur, (...) Nga kjo rrjedh se edhe në procedurën sipas mjeteve të jashtëzakonshme është konfirmuar vendimi i gjykatës së shkallës së dytë përkatësisht i shkallës së parë (...)”*.
34. Si përfundim Gjykata Supreme, konstatoi: *“Prandaj, ... ankesa e ndërhyrësit paraqitet si jolëndore në këtë situatë pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka marrë formën e prerë dhe pasi që janë shterur të gjitha mjetet juridike gjykata e shkallës së dytë, edhe sipas qëndrimit të kësaj Gjykate, ka vepruar drejt duke e hedhur ankesën e ndërhyrësit si të palejuar”*.
35. Në këtë këndvështrim, Gjykata konsideron se pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, të cilat i kishte ngritur në Gjykatën e Apelit nëpërmjet ankesës dhe në Gjykatën Supreme, nëpërmjet kërkesës për revizion, gjykatat në fjalë i janë përgjigjur në mënyrë gjithëpërfshirëse duke arsyetuar në detaje konkluzionet e tyre. Në këtë rast gjykatat e rregullta vlerësuan se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë marrë parasysh edhe nga Gjykata e Qarkut, e cila vlerësoi se ankesat e ushtruara nga paditësi J. G. dhe parashtruesi i kërkesës ishin të pabazuara, duke vërtetuar kështu Aktgjykimin C. nr. 397/2006 të Gjykatës Komunale Prishtinë, të 22 dhjetorit 2009. Më tej, gjykatat vlerësuan se paditësi dhe parashtruesi i kërkesës kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut, Ac. nr. 240/2010 të 14 majit 2010, kishin shterur edhe mjetin e jashtëzakonshëm juridik, revizionin, dhe në këtë rast Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. Mlc. nr. 217/2010 të 16 prillit 2010, kishte hedhur poshtë si të palejuar kërkesën e parashtruesit, ndërsa kërkesa për revizion e ushtruar nga paditësi J. G. ishte refuzuar si e pabazuar.
36. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit e kishte hedhur poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës për arsye thjesht procedurale, duke konsideruar se i njëjti i kishte shterur të gjitha mjetet efektive juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme dhe se Aktgjykimi C. nr. 397/2006 i Gjykatës Komunale në Prishtinë, i 22 dhjetorit 2009 tashmë ishte bërë i plotfuqishëm. Ky konstatim i Gjykatës së Apelit, u konfirmua edhe nga Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. nr. 261/2018, të 30 tetorit 2018, të cilin parashtruesi e konteston në Gjykatë.
37. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjeshtë nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesve të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, paragrafi 21, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005; shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në rastin: KI25/11, me parashtrues *Shaban Gojnovci*, të 28 majit 2012, paragrafi 28; shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

38. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit dhe të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj.
39. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, GJEDNJ rasti *Perlala kundër Greqisë*, paragrafi 25 dhe *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34, dhe shih, gjithashtu rastet: KI70/11, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KI56/17, parashtuese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, para. 41).
40. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih, *mutatis mutandis*, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, rasti KI86/11, me parashtues *Milaim Berisha*, i 5 prillit 2012).
41. Andaj, nga si u tha më sipër, Gjykata vlerëson se parashtuesi i kërkesës, ka pasur mundësi të mjaftueshme që para gjykatave të rregullta t’i prezantojë të gjitha pretendimet për shkelje të të drejtave të tij. Për më tepër, Gjykata konsideron se argumentet e tij janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe janë shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat e rregullta. Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta janë të arsyetuara dhe se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, nuk kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih rastin e GJEDNJ-së *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykim i 30 qershorit 2009).
42. Si përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa, në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë.
43. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, ajo duhet të deklarohet e papranueshme.



## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2019, njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Nexhmi Rexhepi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi